

D E K R E T
Nr. 1501, datë 29.5.1996

**PËR KRIJIMIN E SEKSIONEVE PËR GJYKIMIN E MOSMARRËVESHJEVE
ADMINISTRATIVE, TREGTARE E FAMILJARE, PRANË GJYKATAVE TË RRETHEVE**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 e ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe të nenit 321 të Kodit të Procedurës Civile, me propozimin e ministrit të Drejtësisë

D E K R E T O J:

Neni 1

Të krijohen seksionet për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe seksionet për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve tregtare, në këto gjykata:

1. Në Gjykatën e Rrethit të Tiranës.
2. Në Gjykatën e Rrethit të Durrësit, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në Rrethin e Kavajës.
3. Në Gjykatën e Rrethit të Krujës, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në Rrethin e Kurbinit.
4. Në Gjykatën e Rrethit të Matit, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në Rrethin e Bulqizës.
5. Në Gjykatën e Rrethit të Dibrës.
6. Në Gjykatën e Rrethit të Lezhës, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në Rrethin e Mirditës.
7. Në Gjykatën e Rrethit të Shkodrës, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në rrethin e Malësisë së Madhe dhe të Pukës.
8. Në Gjykatën e Rrethit të Kukësit, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në Rrethin e Hasit.
9. Në Gjykatën e Rrethit të Tropojës.
10. Në Gjykatën e Rrethit të Elbasanit, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në rrethin e Peqinit, të Gramshit dhe të Librazhdit.
11. Në Gjykatën e Rrethit të Fierit, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në Rrethin e Mallakastrës.
12. Në Gjykatën e Rrethit të Lushnjës.
13. Në Gjykatën e Rrethit të Beratit, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në rrethin e Kuçovës dhe të Skraparit.
14. Në Gjykatën e Rrethit të Vlorës.
15. Në Gjykatën e Rrethit të Korçës, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në rrethin e Pogradecit, të Devollit dhe të Kolonjës.
16. Në Gjykatën e Rrethit të Gjirokastrës, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në rrethin e Tepelenës dhe të Përmetit.
17. Në Gjykatën e Rrethit të Sarandës, duke e shtrirë kompetencën tokësore edhe në Rrethin e Delvinës.

Neni 2

Në të gjitha gjykatat e rretheve krijohen seksionet për gjykimin e mosmarrëveshjeve që kanë lidhje me familjen.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi më 1 qershor 1996.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha